VEKON H EGHTÉ I PLOTFUQISHEM

COUNTY OF THOSH ON SUD

GUAL JAN AND AND AND SUD

FLANA I UKOSEVAC

28.04 2017

P. nr.398/17

# NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Gjyqtari i vetëm gjykues Sahit Krasniqi me sekretaren juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të pandehurit, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II. nr.655-4/16, të dt. 10.02.2017, për veprën penale "vjedhje pyllit" nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, në bazë të nenit 495 të KPP-së, me dt. 29.03.2017 mori këtë:

#### AKTGJYKIM

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.655-4/16, të dt. 10 shkurt 2017, dhe kjo gjykatë jepë këtë:

# URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit , nga i ati , i lindur më në fsh.

Komuna Ferizaj, me vendbanim të njejtë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

# ËSHTË FAJTOR

Sepse: me datën 26.04.2016 rreth orës 08:00 në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural në Ferizaj, në rajonin ekonomiko pyjor Nerodime-Jezerc, në vendin e quajtur "Prroni i vogël" me qëllim ka prerë 1 dru të llojit ahu me diametër 60 cm, lartësi të bonitetit III gjithsejtë në kubator prej 1m³, vlerë e dëmit të shkaktuar është 405,00 euro, të cilat drunjë i ka bartur me kali

me të cilën ka kryer veprën penale "vjedhje e pyllit " nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Andaj konform nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 23, 41, 42, 43, 46, 73 të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 495 të KPPK-së,

### GJYKON

juridike të i ja kthej dëmin e shkaktuar në vlerë prej 405.00 euro, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Konform nenit 450 të KPRK-së, obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 euro, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P. nr. 398/17 dt. 29.03.2017

Sekretare Juridike

Gjyqtari i vetëm gjykues

Adelina Sallahu

Sahit Krasniqi

Yleeeleez

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.